



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 790// Prishtinë 25.02. 2021

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Durim Basha** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: "**Efekti i parregullive strukturore në performancën sizmike të ndërtesave nga B.A**", në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Tema e diplomës merret me analizën sizmike të dy ndërtesave shumëkatëshe, të cilat janë të rregullta në plan dhe lartësi duke u bazuar në standardet europiane për dizajnin e strukturave rezistencë ndaj tërmeteve, gjegjësisht në eurokodin 8. Sipas projektimit, ndërtesat të cilat i nënshtrohen analizave janë sisteme ekuivalente të kombinuara me mure, të cilat nuk i plotësojnë kushtet për ngurtësi ndaj përdredhjes (torzionit).

Shembulli i parë është struktura e parregullt ndaj përdredhjes, ndërsa shembulli i dytë struktura e rregullt ndaj përdredhjes. Analiza modale e ndërtesës është llogaritur duke përdorur programin ETABS 18.0.

Reagimi sizmik i strukturës është përcaktuar duke përdorur modele të ndryshme matematikore dhe duke marrë parasysh supozime të ndryshme. Në këtë studim u realizua modelimi i mureve si modele lineare por edhe sipërfaqësore dhe ndikimi i gjerësisë së elementeve vertikale pjesëmarrëse në ngurtësinë ndaj akseve kryesore ku vepron tërmeti.

Ky punim e ka për qëllim të përcaktojë efektin e parregullive strukturore në strukturat nga betoni i armuar sipas kërkesave të projektimit sipas EC8.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.